

community

The New Apostolic Church around the world

01/2025/AI

Eshte koha
të bësh të mira!

Kryeartikulli

Eshtë koha të bësh të mira!

Shërbesa fetare

Të shtrosh rrugën –
për të gjithë

Doktrina

Uniteti dhe diversiteti

New Apostolic Church
International



■ Kryeartikulli

3 Eshtë koha të bësh të mira!

■ Shërbesë fetare

4 Të shtrosh rrugën –
për të gjithë

■ Këndi i fëmijëve

10 Rreth deles së humbur

12 Për vizitë tek Naellein Dakar
(Senegal)

■ Doktrina

14 Uniteti dhe diversiteti i kishës

■ Lajme Globale

18 Të rinjtë ndezin zjarre në
Kanada

Eshtë koha të bësh të mira!

Të dashur vëllezër e motra,

Motoja jonë për vitin 2025 është: "Eshtë koha të bësh të mira!" Dhe si të bëjmë mirë është ajo që na mëson Jezu Krishti.

Zoti dëshiron shpëtimin e të gjithë njerëzve. Fillojeni nga vetja. Pra: bëni diçka të mirë për veten tuaj - përqendrohuni në shpëtimin tuaj.

Sa më shumë ta kuptoni se çfarë të mirash po bën Zoti për ju, aq më shumë rritet dëshira juaj për të bërë vetë të mira.

Sidomos në kishë: Jezusi dëshiron që njerëzit e tij t'i kushtojnë vëmendje njëri-tjetrit, të kujdesen për njëri-tjetrin dhe të ndihmojnë njëri-tjetrin. Ai dëshiron që ne të rritemi së bashku në një unitet të fortë.

Kjo është mënyra se si ne japim një shembull për Jezu Krishtin: Ungjilli i Tij funksionon - në çdo kohë, në çdo situatë. Atëherë edhe të tjerët do të shohin dhe të ndjejnë se: "Gjëra të mira po ndodhin!"



Foto: NAK International

Ne duhet t'u bëjmë gjithmonë të gjithëve pikërisht të mirën që ne vetë do të donim të përjetonim. Le të shfrytëzojmë çdo mundësi; po, le të kërkojmë në mënyrë aktive mundësitë. Fryma e Shenjtë do të na tregojë se çfarë mund të bëjmë.

Le të bëjmë të mira - tani!



Jean-Luc Schneider

Të shtrosh rrugën – për të gjithë



Apostulli kryesor Jean-Luc Schneider festoi një shërbesë në Mzuzu (Malawi) më 30 qershor 2024.

Fotot: NAC Malawi

Isaija 62,10

Hyni, hyni nëpër porta! Përgatitni rrugën për njerëzit! Bëni një shteg, bëni një shteg, pastroni gurët! Vendosni një shenjë për kombet!

Të dashur vëllezër dhe motra, ka gëzim të madh në takimin tonë këtë mëngjes. Arsyeja për këtë është e thjeshtë. Unë mendoj se ne të gjithë ndjejmë nevojën për të adhuruar Zotin dhe për ta falënderuar për hirin dhe mëshirën e Tij. Dhe pastaj ne të gjithë duam të përgatitemi për kthimin e Krishtit, që do të thotë se ne duhet të bëhemi gjithnjë e më shumë si Jezu Krishti. Kjo do të thotë të kesh të njëjtën dashuri dhe dëshirë si Jezu Krishti dhe të bësh të njëjtat vepra që bëri Ai. Jezu Krishti dëshiron që të gjithë njerëzit të shpëtohen. Dhe sa më shumë rritemi në karakterin e Krishtit, aq më shumë rritet brenda nesh kjo dëshirë dhe malli për të kontribuar në shpëtimin e fqinjëve tanë: të gjallëve dhe të vdekurve.

Duke qenë se shërbesa për të larguarit nga kjo jetë do të bëhet të dielën e ardhshme, sot do të fokusohemi te shpirtat në jetën e përtejme, prandaj kemi këtë citim biblik nga libri i profetit Isaia.

Ju e dini historinë e njerëzve në atë kohë. Vendi u pushtua nga armiqtë, mbreti u mund dhe një pjesë e madhe e

popullsisë u dërgua në mërgim. Qyteti i Jeruzalemit u shkatërrua dhe njerëzit ishin shumë të trishtuar. U deshën disa dekada që Zoti të jepte hir dhe të ndryshonte situatën. Ata që mbetën në Jeruzalem u lejuan të rindërtonin qytetin dhe ata që ishin në mërgim u lejuan të ktheheshin në Jeruzalem. Në tekstin tonë biblik, Perëndia u flet atyre që mbetën në Jeruzalem dhe u bën thirrje që të përgatisin rrugën për ata që kthehen nga mërgimi. Ata duhej të vendosnin një shenjë për t'u treguar atyre rrugën dhe për t'u treguar se ky ishte vendi ku ata duhet të ktheheshin. Ju duhet të pastroni gurët, duke ua lehtësuar kthimin. Ky është konteksti i fjalës sonë biblike.

Për ne si të krishterë, si fëmijë apostolik të ri të Zotit, qyteti i Jeruzalemit, Sioni, është një tablo e Kishës së Krishtit. Jeruzalemi është vendi ku Perëndia banon me popullin e tij, ku ne mund të takojmë Perëndinë dhe të kemi shoqëri me të. Ata që janë në mërgim janë të gjithë ata që janë ende nën sundimin e së keqes. Zoti dëshiron t'i shpëtojë dhe t'i sjellë në qytetin e tij, Kishën e Krishtit - si të gjallët ashtu edhe të vdekurit.

Shikoni fqinjin tuaj dhe kontribuoni në shpëtimin e tij.



Përveç Apostullit të Distriktit Kububa Soko, ishin të pranishëm edhe disa ndihmës të apostujve afrikanë të distriktit si dhe apostuj të tjerë



Uniteti i popullit të Zotit është një shenjë se: Këtu është vendi, ku Zoti vepron.

Dhe ai na thotë neve që tashmë jetojmë në këtë qytet të dalim dhe të ngremë një shenjë dhe të heqim gurët që ata të gjejnë rrugën e tyre dhe të vijnë në Jeruzalem. Imazhi që përdor Isaia për të hyrë nga portat nuk do të thotë që ne duhet të largohemi nga kisha. Këtu i referohem shëmbëlltyrës së Jezusit kur ai përshkroi qëndrimin e Zotit ndaj mëkatarëve në shëmbëlltyrën e djalit plangprishës. I riu u largua nga shtëpia, por kur vendosi të kthehej në shtëpi, babai i tij, në këtë rast Zoti, nuk qëndroi në shtëpi dhe e priste, por vrapoi ta takonte dhe iu hodh në qafë.

Me këtë histori, Jezusi donte të tregonte dashurinë e Perëndisë për mëkatarët. Dhe Zoti na thotë të dalim edhe ne. Kjo do të thotë që ne nuk duhet të interesohemi vetëm për shpëtimin tonë. Ne gjithashtu duhet të kujdesemi për shpëtimin e fqinjëve tanë. Nuk duhet të jemi egoistë.

Shikoni fqinjin tuaj dhe kontribuoni në shpëtimin e tij. Shkoni tek ai. Kjo do të thotë që ne të kujdesemi për të, të

marrim pjesë në vuajtjet e tij dhe të solidarizohemi dhe të bëjmë të ditur se nuk jemi më të mirë se ai. Duhet ta takojmë atë sit ë barabartë me ne. Kjo do të thotë se ne nuk besojmë se e meritojmë shpëtimin sepse jemi më të mirë se të tjerët. Ne nuk e meritojmë të jemi fëmijë të Zotit. Është mëshira e tij që e bën

këtë. Ne nuk jemi më të mirë se të tjerët. Dhe ne dëshirojmë që fqinji ynë të marrë të njëjtin hir që kemi marrë ne. Ndaj duhet të jemi të ndjeshëm ndaj vuajtjeve të të tjerëve, të solidarizohemi me ta dhe të jemi të vetëdijshëm se të gjithë jemi njësoj sepse të gjithë jemi mëkatarë dhe askush nuk e meriton shpëtimin.

Si mund të ndërhyjmë për njerëzit në botën e përtejme? Nëpërmjet lutjeve tona, ne mund të ndërmmjetësojmë për ta. Dhe kjo është thirrja e Atit tonë Qiellor: Lutuni për njerëzit në jetën e përtejme, tregojuni atyre dashurinë tuaj dhe lutuni për shpëtimin e tyre. Mos u lut vetëm për veten tënde. Mos u shqetëso vetëm për shpëtimin tënd. Mendoni për shpëtimin e fqinjit tuaj. Kontaktoni të tjerët, tregojuni

Shërbesa fetare u shoqërua edhe me pjesë muzikore



atyre rrugën, në mënyrë që ata të dinë se ky është vendi ku duhet të shkojnë. Ky është vendi ku Zoti banon me popullin e tij. Ky është vendi ku ne mund të gjejmë shpëtim. Ky është drejtimi drejt të cilit duhet të shkojmë.

Si mund të vendosim një shenjë për të gjallët dhe të vdekurit që të dinë se ky është vendi? Para së gjithash, duke i shprehur mirënjohjen tonë Zotit. Falënderojmë Zotin për shpëtimin tonë në ditët e mira dhe të këqija. Edhe kur jemi në nevojë dhe përballemi me kohë të vështira, ne jemi ende mirënjohës. Ne jemi mirënjohës për dashurinë e Perëndisë, për hirin e Tij dhe për shpëtimin e Tij. Dhe kjo i ndihmon të tjerët të kuptojnë rëndësinë e shpëtimit dhe hirit. Ata shohin, "Oh, kjo duhet të jetë diçka e veçantë, sepse ata janë ende mirënjohës edhe përballë vështirësive, kështu që ne duam të vendosim një shenjë në mënyrë që ata të mund të shohin dhe të njohin: "Oh, këtu ka shpëtim". Ata janë mirënjohës si në ditët e mira ashtu edhe në ato të këqija. Mënyra se si ne sillemi në jetën e përditshme tregon se shpëtimi është këtu. Njerëzit duhet të kuptojnë se si fëmijë të Perëndisë ne nuk jemi më të detyruar të ndjekim djallin. Zoti na ka mundësuar që të veprojmë dhe të sillemi ndryshe. Ne nuk reagojmë si gjithë të tjerët, por veprojmë sipas vullnetit të Zotit në çdo situatë.

Le të sillemi si dishepuj të vërtetë të Krishtit. Le të mos lejojmë të tjerët të ndikojnë në sjelljen tonë. Edhe kur ata bëjnë gabim, ne bëjmë atë që është e drejtë. Fyerjeve nuk i përgjigjemi me sharje dhe nuk e kthejmë as të keqen me të keqe. Ne nuk jemi më nën kontrollin e mëkatit. Kemi mundësi të bëjmë mirë. Le ta bëjmë atëhere!

Jezusi tha: "Duajeni njëri-tjetrin. Nga kjo do ta dinë të gjithë se jeni dishepuj e mi, nëse keni dashuri për njëri-tjetrin" (shih Gjoni 13,34-35). Ai madje u lut: O Atë, le të jenë ata një, në unitet, që njerëzit të besojnë se ti më ke dërguar. Dashuria për vëllanë dhe motrën time në kishë, uniteti, njëshmëria e popullit të Zotit, është shenja që tregon: Ky është vendi ku vepron Zoti; këtu është vendi ku unë mund ta mposht mëkatin; këtu është vendbanimi i Perëndisë në tokë. Kjo është shenja. Të dashur vëllezër dhe motra, mirënjohja jonë ndaj Zotit në ditët e mira dhe të këqija, sjellja jonë, refuzimi ynë për të kthyer të keqen me të keqe, dashuria për njëri-tjetrin dhe njëshmëria e popullit të Zotit janë shenja që u tregojnë njerëzve: "Ejani, këtu është Shpëtimi."

Pastaj ne duhet të heqim pengesat, gurët, nga rruga. Çfarë mund të jetë pengesë për njerëzit këtu në tokë dhe në jetën e

përtejme për të pranuari mësimet tona? Ka një gur që është një pengesë e madhe. Dhe pikërisht atëherë ne kërkojmë që ata të bëhen si ne dhe ne u imponojmë rregullat tona: Nëse duan shpëtim, ata duhet të jenë apostolikë të rinj për aq kohë sa kemi qenë ne. Nëse duan të shpëtohen, duhet të punojnë për aq kohë sa punuam ne. Nëse ata duan të shpëtohen, ata duhet të vuajnë në të njëjtën mënyrë që vuajtëm ne. Nëse ata duan të shpëtohen, ata duhet të bëhen si ju dhe unë. Dhe kjo e bën të pamundur shpëtimin e tyre. Hiqini këta gurë nga rruga!

Ne nuk duam të sillemi si vëllai i madh i djalit plangprishës që nuk ishte i lumtur që Ati i tregoi mëshirë vëllait të tij më të vogël. Jezusi e dënoi këtë dhe mos u bëni si punëtorët e vreshtit që u zemëruan, sepse punëtorët e fundit morën të njëjtën pagë si punëtorët e parë. Të gjithë meritojnë mëshirë. Mos u impononi atyre rregullat tuaja. Lejoje Zotin t'i bëjë mirë fqinjët tuë dhe largoje këtë pengesë.

Një pengesë tjetër: Për shembull, kur i akuzojmë shpirtat në jetën e përtejme, akuzat dhe gjykimet tona bëhen pengesë në rrugën e tyre drejt shpëtimit. Si mund të bashkohen me besimin tonë nëse ndiejnë: “Nuk jemi të mirëpritur. Ata na akuzojnë”. Nuk mund të ketë më akuza dhe paragjykim. Ne duhet t'i falim ata siç na ka falur Zoti. Kjo është një pengesë, një gur që ne mund ta heqim.

Megjithatë, ka gurë të tjerë, pengesa të tjera që nuk mund t'i heqim. Gjëra që e bëjnë të vështirë shpëtimin e njerëzve dhe që ne nuk mund t'i eliminojmë. Por ne mund t'i ndihmojmë ata t'i kapërcejnë këto pengesa. Një pengesë e madhe, një gur i madh, është papërsosmëria jonë. Ju ftoj: “Ejani! Këtu është puna e Zotit”, dhe pastaj ata shikojnë përreth dhe shohin: “Por ata janë gjithçka tjetër veçse të përsosur. Ata supozohet të jenë shenjtorë. Vetëm shikoni ato. Shikoni apostujt, klerikët, ata janë gjithçka tjetër veçse të shenjtë. Ka kaq shumë konflikte në bashkësi.”

Ky është një gur i madh që i pengon shpirtat të bashkohen me ne. Dhe kjo është një pengesë që ne nuk mund ta heqim, sepse të gjithë ne - dhe unë jam i pari për të cilin kjo vlen - jemi dhe do të mbetemi mëkatarë deri në fund. Edhe kur bëjmë më të mirën, gjithmonë do të ketë konflikte në bashkësitë tona. Ne gjithmonë do të mëkatojmë. Të gjithë bëjmë gabime. Ne nuk mund ta heqim këtë gur, por mund t'i ndihmojmë shpirtat t'i kapërcejnë këto pengesa, për shembull duke u treguar atyre se si i trajtojmë dhe se si i zgjidhim ne konfliktet.

Ne jemi të papërsosur, por shpirtat duhet të jenë në gjendje të kuptojnë se jemi të sinqertë. Dhe ne kurrë nuk duhet të ndalojmë së punuari me veten dhe duke u përmirësuar. Ne



Ndihmës apostuli i distriktit Arnold Mhango doli në pension në këtë shërbesë fetare

duam të tregojmë përlësi dhe pendim dhe të kërkojmë mëshirë. Në këtë mënyrë ne mund t'i ndihmojmë këta shpirta të kapërcejnë pengesat që dalin nga papërsosmëria jonë. Ne mund t'u tregojmë: “Po, ka konflikte, por shikoni si i zgjidhim. Sigurisht, ne bëjmë mëkate, por jemi të sinqertë, të përlur dhe të penduar dhe kërkojmë falje. Dhe po, ne bëjmë gabime, por ne po përpiqemi të përmirësohemi. Në këtë mënyrë, ne mund t'i ndihmojmë ata të kapërcejnë këtë pengesë.

Një tjetër pengesë është papërsosmëria e tyre. Ata janë njerëz të dobët si ne dhe më pas ne u themi atyre se duhet të bëhen si Jezu Krishti. Dhe më pas e kuptojnë se nuk do të mund ta bëjnë kurrë: “Është shumë e vështirë. Unë nuk mund ta bëj këtë.” Ne mund t'i ndihmojmë ata duke ua bërë të qartë se Zoti i do ata ashtu siç janë. “Besojeni Perëndinë. Ai do t'ju ndihmojë. Ai ju jep fjalën e tij, hirin e tij dhe Darkën e Shenjtë. Ju do të integrohni në bashkësinë e fëmijëve të Zotit. Dhe me ndihmën dhe hirin e Perëndisë dhe me ndihmën e vëllezërve dhe motrave të tjerë, ju mund të kapërceni papërsosmërinë tuaj dhe ta arrinë këtë.” Dhe nëpërmjet këtij ngushëllimi nga Fryma e Shenjtë, ne mund t'i ndihmojmë ata të kapërcejnë këtë pengesë.

Ekziston edhe një pengesë e tretë, ajo e fundit, të cilën nuk mund ta heqim. Jezusi tha: “Nëse dikush dëshiron të më ndjekë, le ta mohojë vetveten, të marrë kryqin e tij dhe të më ndjekë” (Mateu 16,24). Ky është një rregull hyjnor. Të ndjekësh Krishtin përfshin përballjen me vështirësitë dhe kundërshtimin e armikut. Për ta ndjekur Atë, njeriu duhet

Apostuli kryesor Jean-Luc Schneider flet direct me motrat e vëll e admin



të heqë dorë nga një sërë gjërash. Dhe kjo është shumë e vështirë. Dhe kjo është një pengesë, por ne mund të ndihmojmë për ta kapërcyer këtë pengesë duke u treguar shpirttrave se sa e rëndësishme dhe e madhe është lavdia e Atit tonë Qiellor. Çfarëdo që të kalojmë këtu në tokë, ne e dimë se ia vlen të qëndrojmë besnikë, sepse lavdia në qiell do të jetë aq e madhe sa nuk do t'i kujtojmë as vuajtjet tona në tokë. Mos u dorëzo, vazhdo, lufta ia vlen. Shoqëria në qiell është shumë më e madhe se të gjitha gjërat që po kaloni sot.

Le t'i ndihmojmë këta shpirttra të kapërcejnë pengesat që nuk mund të hiqen. Dhe çfarëdo që ne mund të heqim nga rruga, le ta bëjmë.

Pra, këto ishin pengesat që ndalojnë shpirttrat në botën e përtejme. Por unë gjithashtu e di se ne kemi vëllezër dhe motra që janë larguar nga qyteti i Perëndisë. Arsyet janë të shumta. Disa thjesht u mashtruan dhe u larguan. E njëjta fjalë vlen edhe për ta. Ne duam që ata të shpëtohen njësoj me ne. Ne ende lutemi për shpëtimin e tyre. Është e vështirë për ata që të kthehen. Le të heqim ne pengesat. Vëllezër dhe motra, pa i akuzuar, pai fajësuar, por me falje, me dashuri

dhe mirënjohje kur të kthehen. Pra, ne u tregojmë atyre se ky është vendi ku vepron Fryma e Shenjtë dhe ku Perëndia banon me popullin e tij. Sjellja këtu është ndryshme. Ne duam t'u bëjmë të ditur se janë të mirëpritur, se i duam. Ne duam që ata të shpëtohen njësoj si ne. Le t'i heqim gurët nga rruga: pa akuza apo gjykime. Ne thjesht duam të jemi të qetë dhe të falim dhe t'u themi atyre se janë të mirëpritur në mesin tonë.

Mendoni për historinë e djalit plangprishës.

MENDIME KYÇE.

Ne e dëshërojmë shpëtimin e tjetrit. Mirënjohja jonë, sjellja jonë dhe dashuria ndërmjet njëri-tjetrit konfirmojnë, pohojnë, që Krishti punon në Kishë. Ne tregojmë dhembshuri dhe kujdes ndaj të tjerëve.

DELJA E HUMBUR

SIPAS LUKËS 15,1-7


Kur Jezusi flet, dëgjojnë të gjithë – burra, gra, femijë. Një herë Jezusi tregoi historinë e deles së humbur:

“Nëse një bari ka njëqind dele dhe njëra prej tyre i humbet – ia mbath apo humb rrugën – çfarë do të bëjë bariu? A nuk i lë pas nëntëdhjetë e nëntë delet dhe e kërkon delen e humbur? Ai kërkon të gjitha vendet se ku mund të kishte shkuar ajo. Ai ndalon për të parë nëse mund ta dëgjojë atë diku. Dhe këtë e



bën derisa ta gjejë atë.
Kur e gjen sërish delen, gëzohet
pa masë. Bariu e merr në
krahë, e vendos mbi supe dhe
e çon në shtëpi. Ai u thotë të
gjithë miqve dhe fqinjëve të tij:
,Gëzohuni me mua. Gjeta delen
time të humbur.'
Në të njëjtën mënyrë do të ketë
gëzim në qiell për një mëkatar

që pendohet. Zoti është më
i kënaqur me të sesa me
nëntëdhjetë e nëntë njerëz të
drejtë që nuk kanë nevojë për
pendim.”



PËR VIZITË TE NAELE NË DAKAR (SENEGAL)


Unë quhem Naelle dhe jam shtatë vjeç. Unë jam më i vogli në familjen tonë. Kam dy motra, Trejsi dhe Gerti, dhe një vëlla, Joven. Ata janë 14, 12 dhe 17 vjeç.



Familja ime jeton në Dakar, kryeqyteti i Senegalit në pjesën perëndimore të Afrikës. Ne flasim frëngjisht, por vëllai dhe motrat e mia flasin gjithashtu Wolof, një nga gjuhët lokale.

Senegali ka një sezon të thatë nga nëntori deri në qershor. Kjo do të thotë se nuk bie fare shi gjatë kësaj kohe. Shpesh bie shi nga korriku deri në tetor. Për shkak se Dakar është buzë detit dhe nuk bën ftohtë as në dimër, mund të lahesh gjatë gjithë vitit - ose të ecësh në plazh ose të kërcesh në rërë. Njerëzit këtu e duan muzikën dhe kërcimin.

Senegali ka një sezon të thatë nga nëntori deri në qershor. Kjo do të thotë se nuk bie fare shi gjatë kësaj kohe. Shpesh bie shi nga korriku deri në tetor. Për shkak se Dakar është buzë detit dhe nuk bën ftohtë as në dimër, mund të lahesh gjatë gjithë



vitit - ose të ecësh në plazh ose të kërcesh në rërë. Njerëzit këtu e duan muzikën dhe kërcimin.

Unë do të shkoj në klasën e parë. Parashkollorin dhe vitin e parë të fillores e kam kryer me nota shume te mira. Unë këndoj që në moshën katër vjeçare. Ashtu si nëna ime, motrat dhe vëllai im, edhe unë jam në kor. Edhe pse jam më e vogla atje, më pëlqen shumë.

Kur nuk jam në shkollë apo në kishë, më pëlqen të luaj me Puzzle ose të ngas skuter. Gjithashtu kaloj shumë kohë në telefon - për shembull me Juniorin, ai është prifti ynë dhe drejtues i korit. Ai lutet me mua në telefon dhe më inkurajon që të përpiqem gjithmonë shumë në shkollë. Është mirë që më të rriturit i ndihmojnë të rinjtë.

Ushqimi im i preferuar është

Fumbwa, e cila është një perime që të kujton pak spinaqin. E hamë me pastë kikiriku dhe mish. Më pëlqen gjithashtu mishi i pulës me salcë me qepë dhe me limon - dhe sigurisht Burger dhe pica.

Bashkësia jonë ofron trajnime muzikore për të rinj dhe fëmijë. Unë luaj soprano në fyell dhe po mësoj t'i bie violinës. Një ditë dua të luaj njësoj si motrat e mia.





Foto: evening_tao - stock.adobe.com

| Uniteti dhe diversiteti

Bashkësi që rriten përmes emigracionit, kultura që takohen, informacione që udhëtojnë anembanë globit me shpejtësi rrufeje: për kishën kjo nuk është vetëm një bekim, por edhe një sfidë. Por ka një përgjigje të përgjithshme dhe gjithmonë të vlefshme për këtë.

Kjo ese u prezantua në Takimin Ndërkombëtar të Apostujve të Distriktit në vjeshtën e vitit 2023 dhe u botua në numrin e veçantë 1/2024. Në shërbesën e tij apostulli kryesor komenton, se ndër të tjera kjo konsiston në ruajtjen dhe promovimin e unitetit të Kishës dhe përhapjen e njëtrajtshme të dëshmisë së besimit (Katekizmi i Kishës Apostolike, të Re Artikulli 7.6.6). E lidhur ngushtë me këtë është tema e universalitetit të kishës, Ungjillit dhe shpalljes së tij. Një ese me temën "Përgjithësia e Kishës" është trajtuar tashmë në numrin e veçantë 4/2017 dhe në revistën Community 1/2019. Për këtë arsye mendime rreth kësaj teme do të vazhdojnë të thellohen më poshtë.

Lëvizjet migratore – bekim dhe sfidë

Në fillim të historisë së saj, Kisha Apostolike e Re u rrit përmes emigrimit. Kryesisht falë besimtarëve nga Evropa gjermanishtfolëse, kisha mundi të fitonte një terren në Amerikë, Australi dhe në disa vende afrikane. Mërgimtarët ftuan fillimisht bashkatdhetarët e tyre. Shërbesat kryheshin në gjermanisht dhe bashkësitë u ndikuan nga kultura gjermanishtfolëse. U desh shumë kohë që të ndodhte një ndryshim në të menduar. Por kisha gradualisht iu përshtat kushteve lokale, duke hapur rrugën për integrimin e besimtarëve nga një shumëllojshmëri kulturash.

Kisha jonë ka përjetuar një migrim të fortë nga Afrika për disa dekada. Shpërngulja e besimtarëve nga Afrika është një bekim i vërtetë për Kishën në pjesë të tjera të botës. Besimi, energjia dhe përkushtimi i tyre sjellin dinamizëm të ri në bashkësitë, të cilat kanë shumë nevojë për të. Megjithatë, kjo lëvizje paraqet edhe një sfidë për kishën. Të ardhurit kanë kulturën e tyre apostolike të re, e cila ndryshon dukshëm nga ajo e vendasve. A mund t'i kërkohet një bashkësi të "afrikanizohet" vetëm sepse shumica e anëtarëve të saj vijnë nga Afrika? Apo duhet të shtyhen të ardhurit të përshtaten në kulturën vendase? Ky problem ka ekzistuar gjithmonë. Megjithatë, në shoqërinë e sotme ka një rëndësi të veçantë. Të përballur me zhvillime jashtë kontrollit të tyre dhe të shqetësuar për të ardhmen e tyre, njerëzit ndonjëherë priren të tërhiqen dhe të kapen pas vlerave tradicionale. Kjo sjellje mund të gjendet edhe në bashkësitë tona, në mesin e "vendasve" si dhe "të ardhurve". Si duhet t'i përgjigjet dikush kësaj sfide?

Larmia e besimtarëve – Bekim dhe sfidë

Shumica e bashkësive tona përbëhen nga besimtarë të moshave dhe shtresave të ndryshme të jetës, të bashkuar nga besimi në Krishtin dhe përkushtimi ndaj apostulatit. Kjo larmi është ajo që e bën kishën tonë kaq të pasur. Me ndihmën e Frymës së Shenjtë, apostullati ka kërkuar gjithmonë të plotësojë nevojat dhe pritshmëritë e çdo kategorie besimtarësh. Nuk është gjithçka perfekte, por mendoj se kisha ka bërë një punë mjaft të mirë për këtë.

Shoqëria sot tenton të favorizojë individin mbi kolektivin. Njerëzit theksojnë veçantinë e tyre, theksojnë dallimin e tyre dhe presin që pritshmëritë e tyre specifike të përmbushen. Ata bëhen më kërkues dhe më pak tolerantë. Kjo prijë vërehet edhe në kishë.



Photo: Luluraschi - stock.adobe.com



Fotot: Luluraschi - stock.adobe.com

Disa anëtarë të kishës duan që kisha të përfshihet më shumë në shoqëri për të kompensuar të metat e qeverive. Të tjerë janë të mendimit se angazhimi shoqëror nuk është një nga detyrat e kishës. Disa besimtarë duan t'u thuhet saktësisht se si duhet të sillen në mënyrë që të bekoen. Të tjerë, megjithatë, pretendojnë lirinë e tyre dhe refuzojnë çdo ndërhyrje të kishës në jetën e tyre private. Disa duan që asgjë të mos ndryshojë në kishë, të tjerë duan të ndryshojnë gjithçka. Një pjesë dëshiron emocione, një pjesë tjetër dëshiron mendim, përmbajtje. Nuk është e mundur t'i kënaqësh të gjithë.

Globalizimi i Informacionit – Bekim dhe sfidë

Falë internetit, informacioni rrjedh lehtësisht dhe shpejt nëpër botë. Ky zhvillim e ka lehtësuar shumë punën e apostullit dhe të Kishës në përgjithësi. Por kjo sjell me vete edhe një sërë komplikimesh. Ajo që thuhet në një vend ose për një grup besimtarësh ka të ngjarë të përhapet në të

gjithë botën në një periudhë shumë të shkurtër kohore. Pak a shumë e vërtetë dhe shpesh e nxjerrë jashtë kontekstit. Ky lloj komunikimi është krejtësisht i papërshtatshëm për trajtimin e temave komplekse që kërkojnë kohë dhe mendim të thellë.

Përgjigja jonë – Ungjilli universal

Përballë këtyre sfidave, apostujt e sotëm kanë të njëjtin qëndrim si apostulli Pavël. “Sepse Judenjtë kërkojnë shenja dhe grekët dituri, por ne predikojmë Krishtin e kryqëzuar, gur pengese për Judenjtë dhe marrëzi për johebrenjtë; Por të thirrurve, si Judenjtë dhe Grekët, ne u predikojmë Krishtin si fuqinë e Perëndisë dhe urtësinë e Perëndisë” (1 Korintasve 1,22-24). Ne e fokusojmë predikimin tonë në Ungjillin universal, në atë që vlen për të gjithë. Universaliteti i Ungjillit qëndron në atë që Jezu Krishti na mëson për Perëndinë, për ne, për marrëdhënien tonë me Perëndinë dhe njerëzit e tjerë dhe për shpëtimin që Perëndia na ofron. Ne shpallim përsosmërinë dhe dashurinë e Zotit. Ne shpallim se Ai dëshiron të na japë jetë të përjetshme, lumturi të përsosur dhe të përjetshme. Ne e dimë se dashuria e Perëndisë nuk shërben për të përmbushur çdo dëshirë të mundshme të njeriut, por për t'i dhënë atij atë që është e nevojshme për shpëtimin e tij.

Shpallja universale e Ungjillit

Le të kujtojmë se si Pali predikoi Ungjillin. “Sepse, megjithëse jam i lirë nga të gjithë, e bëra veten skllav të të gjithëve, që të fitoj sa më shumë. Unë u bëra si një Jude për Judenjtë, që të fitoja Judenjtë. Me ata që janë nën ligj jam bërë si një nën ligj, megjithëse nuk jam nën ligj, që të fitoj ata që janë nën ligj. Për ata që janë pa ligj u bëra si një pa ligj - megjithëse nuk jam pa ligj përpara Perëndisë, por jam në ligj përpara Krishtit - që të fitoj ata që janë pa ligj. U bëra i dobët ndaj të dobët, që të fitoja të dobët. Unë jam bërë gjithçka për të gjithë, që të shpëtoj disa në çdo mënyrë” (1 Korintasve 9,19-22).

I rritur në besimin judaik, Apostulli Pal besonte se Ligji i Moisiut ishte i shenjtë, i mirë dhe i drejtë (Romakëve 7,12). Ai ende nuk donte t'ua detyronte atë johebrenjve. Gjëja më e rëndësishme për të ishte të zgjonte tek ata besimin te Jezu Krishti. Sot shumica e të krishterëve e njohin vlefshmërinë e Dhjetë Urdhëresave. Megjithatë, mënyra se si ata i interpretojnë ato varet nga mjedisi i tyre kulturor dhe situata e tyre personale. Nuk është roli i apostujve të ndërmjetësojnë mes kulturave të ndryshme dhe aspiratave të besimtarëve. Përkundrazi, puna e tyre konsiston në

shpalljen e çdo personi se Perëndia i do ata ashtu siç janë dhe se Ai dëshiron t'i shpëtojë. Dhe për t'i treguar se ai e ka vendin e tij në kishë, se ai është i respektuar, i kuptuar dhe i dashur atje.

Pali e bëri veten të dobët mes të dobëve. Kush është i dobët? Kur bëhet fjalë për t'iu bindur urdhëresave, të gjithë priren ta shohin tjetrin si të dobët.

Le të marrim si shembull urdhëresën e katërt. Afrikanët janë të ofenduar nga mënyra sesi evropianët i trajtojnë të moshuarit e tyre. Për ta, vendosja e prindërve të tyre në një shtëpi pleqsh është një shkelje e urdhëresës së katërt. Nga ana tjetër, perëndimorët janë të indinjuar që ka ende vende në afrikë ku prindërit e shkelin në këtë urdhër dhe detyrojnë fëmijën e tyre të marrë një bashkëshort/e të zgjedhur prej tyre.

Në një pjesë të botës, homoseksualiteti shihet si një mëkat veçanërisht i rëndë. Bota perëndimore akuzohet se tregon dobësi dhe është fajtorë që e toleron atë. Shumë njerëz në Perëndim janë të indinjuar nga korrupsioni në disa vende. Ata nuk mund ta kuptojnë pse të krishterët përdorin metoda që konsiderohen moralisht të dënueshme për të arritur diçka. Lista mund të zgjerohet pafundësisht. Secili prej nesh është i dobët në sytë e dikujt. E vërteta është se në të gjithë jemi të dobët përpara Perëndisë.

Të jesh i dobët me të dobëtit nuk do të thotë të aprovosh gjithçka që ata bëjnë dhe mendojnë. Kur përballësh me të dobëtit, mbi të gjitha duhet të kujtosh dobësinë tënde dhe në asnjë rrethanë të mos e konsiderosh veten më të mirë se ata. Ne e dimë se Perëndia i do të dobëtit ashtu siç na do ne. Zoti nuk na dënon për dobësitë tona, por është i durueshëm me ne. Le të veprojmë ndaj të dobëve ashtu siç vepron Perëndia ndaj nesh.

Nuk na takon ne të masim besimin dhe dashurinë e të tjerëve nëpërmjet sjelljes së tyre. Mendimi që kemi për njerëzit tanë nuk ka asnjë ndikim në dashurinë që u tregon Perëndia atyre. Por mund të funksionojë në disavantazhin tonë. Perëndia do të na gjykojë bazuar në mënyrën se si

sillemi ndaj fqinjëve tanë. Sidomos ndaj vëllezërve dhe motrave të tij "më të vegjël" (Mateu 25,40), të cilët janë të dobët në sytë tanë...

Në mënyrë që predikimi i tyre të jetë efektiv, apostujt duhet të mësojnë atë që u tha Jezusi (Mateu 28,20). Tani Zoti ka deklaruar gjithmonë se urdhëresa e dashurisë ka përparësi mbi të gjitha dispozitat e ligjit (Mateu 22,3-40). Apostulli Pal e kuptoi në mënyrë të përsosur: «Askujt nuk i detyrohemi asgjë përveçse ta duam njëri-tjetrin; Sepse kushdo që do tjetrin, ka përmbushur ligjin. Për atë që thuhet: "Mos shkel kurorën; mos vrit; mos vidh; mos lakmo", dhe të gjitha urdhërimet e tjera përmblihen në këtë fjalë: "Duaje të afërmin tënd si veten tënde." Dashuria nuk i bën dëm të afërmit. Pra, dashuria është përmbushja e ligjit" (Romakëve 13,8-10).

Le të shpallim pa u lodhur Ungjillin e Jezu Krishtit, ai është vërtet universal!



Masthead

Publikuesi: Jean-Luc Schneider, Überlandstrasse 243, 8051 Zyrih/Zvicër

Shtëpia Botuese Friedrich Bischoff GmbH, Frankfurter Str. 233, 63263 Neu-Isenburg/Germany

Editori: Simon Heiniger

Të rinjtë ndezin zjarre në Kanada

Të bësh miq ishte e lehtë. Rreth 1000 të rinj nga e gjithë Amerika, Australia dhe Gjermania Jugore u mbledhën në fillim të gushtit për të ndriçuar të gjithë së bashku dhe për të përcjellë shkëlqimin e tyre.

Vetë pjesëmarrësit vendosën në ditën e fundit moton e Ditës së Rinisë



Fotot: Hayden Careless, NAC Canada



"Nuk e di nëse e keni vënë re, por ne kemi veshur saktësisht të njëjtën bluzë" "Uau, ne duhet të jemi patjetër miq!" Një foto në Instagram tregon ditën e Rinisë Panamerikane 2024 duke shkelur syrin: Kur dy të rinj takohen këtë fundjavë në mjediset e Universitetit Brock në St. Catharines (Kanada), ata do të ndihen të lidhur nga besimi i tyre dhe nga gëzimi që janë pjesë e kësaj ngjarje.

Pothuajse 1000 të rinj nga Australia, Bolivia, Kili, Paraguaj, Uruguai, Brazili, Argjentina, SHBA, Gjermania dhe Kanada do të marrin pjesë në këtë event nga 2 deri më 5 gusht. Në këtë mënyrë, një foto me dron në hapjen e eventit shfaq flamujt e vendeve. Nën duartrokitje entuziaste, dronët formojnë gjithashtu emblemën e Kishës Apostolike së Re dhe moton e Ditës së Rinisë SHINE.

Njohje me njëri-tjetrin me shpejtësinë e dritës

Motoja, e cila bazohet në Mateu 5,16 ("Le të shkëlqejë drita juaj..."), zbatohet që nga dita e parë. Në hapjen e ditës së tyre, të rinjtë punojnë së bashku për të ndërtuar kulla të

mëdha prej kartoni, balona dhe drita që shkëlqejnë deri në natën që po afrohet.

Gjuhët nuk përfaqësojnë një pengesë, nëse është e nevojshme, mund të komunikojnë me duar dhe këmbë. Njihen lehtësisht me njëri-tjetrin, qoftë duke luajtur futboll dhe basketboll ose duke luajtur lojëra në tavolinë dhe kompjuter. Dhe nëse ndonjëherë humbasin në kampusin e madh universitar, një nga ndihmësit e shumtë me kapelle ku shkruhet SHINE do t'ju afrohet për t'i ndihmuar, duke i ndriçuar, para se të kuptojnë se kanë ndonjë problem.

Mësojnë të shkëlqejnë, të ndriçojnë së bashku

Në një seminar, të rinjtë do të mësojnë se si ta lënë dritën e tyre të shkëlqejë në bashkësinë e tyre, duke bërë një test personaliteti. Dhe që të shkëlqejë fare, çdo njeri ka nevojë për shëndet mendor. Kjo është ajo që tregohet në referatin "Duaje veten mjaftueshëm për të mos u dorëzuar kurrë".



Programi plot ngjyra ofroi kohë për diskutime me apostullin kryesor dhe momente soditëse në kujtim të shpirtave të atyre që tashmë nuk rrojnë.



Pjesëmarrësve u kërkohet të vendosin dorën në zemrën e tyre dhe të thonë "Ja vlen - jam mjaftueshëm": "Dashuria e Zotit vihej re në atë atmosferë të relaksuar dhe në lidhje të thellë me të gjithë pjesëmarrësit. "Gjithçka dukej si një kujdes i vërtetë shpirtëror," thotë një pjesëmarrëse.

Më shumë se një fije shprese

Ditët filluan me joga, devocione në mëngjes ose, për ata që zgjohen vonë, një mëngjes tipik kanadez. "Kur je bashkë me njerëz nga e gjithë bota dhe kur e nis ditën me Zotin, thjesht vëren se dashuria është e njëjtë", thotë me entuziazëm një i ri.

Edhe apostulli kryesor Jean-Luc Schneider erdhi gjithashtu në Universitetin Brock. Ai gjeti kohë për të folur me të rinjtë. Çfarë momentesh SHKËLQIMI ka pasur në jetën e tij? Ai mendohet për pak: Nuk ishin momentet e mëdha që patën një ndikim të madh tek ai, që e kanë prekur shumë atë, porse takimet me bashkëbesimtarët të cilëve iu desh të

mbanin barrë të rënda dhe që nuk u dëshpëruan, nuk u lëkundën asnjëherë. Kjo e motivonte gjithmonë për të kryer detyrat e tij.

Një e ashtuquajtur përvojë SHINE është në program të shtunën në mbrëmje. Përafërsisht 1000 pjesëmarrësit e Ditës së Rinisë transportohen në Kishën Qendrore me autobusë të verdhë shkollorë. Të rinjtë harmonizojnë mbrëmjen me një video për krijimin e botës. Në sallën e errët papritmas shfaqen bateri me ndriçim të fortë. Një grup luan, topa të ndezur kërcëjnë mbi turmën dhe Brandon Leake, i cili fitoi America's Got Talent në vitin 2020, përshëndetet me duartrokitje të forta. Ai kryen një slam të poezisë së krishterë. Të rinjtë aktivizohen edhe vetë duke kërcyer e kënduar së bashku.

Vigilja e qirinjeve më vonë në mbrëmje në mjediset e universitetit është më e qetë dhe më e menduar. Kujtohen me qirinj dhe muzikë shpirtat e shumtë që tashmë janë larguar nga kjo jetë.

Shembull, model ndriçimi

formojnë korin e madh dhe të ftuarit amerikano-jugor dhe gjermanë performojnë „Brillarë“ dhe „Dashuria e Zotit, Hiri i Zotit“. Gjatë shërbesës, apostulli kryesor shpjegon se si mund të bëhet dikush si Jezusi për të treguar dashurinë e Perëndisë.

Më pas, të rinjtë të gjithë udhëtojnë me makina drejt Ujëvarës së Niagarës, ku i pret një shfaqje e madhe dritash me fishekzjarre. Edhe pse nuk u vu në skenë posaçërisht për Ditën e Rinisë, thajse ndjehet si e tillë, sepse kudo sheh të rinj me të njëjtët byzlylkë të ndezur dhe të njëjtat bluza të bardha me logon SHINE.

Pasqyra

05.01.2025	St. Gallen (Zvicër)
12.01.2025	Spreewald (Gjermani)
18.01.2025	Moissaia (Çad)
19.01.2025	L'Djamena (Çad).
31.01.2025	Kampala (Uganda)
02.02.2025	Nairobi (Kenia)
09.02.2025	Heidenheim (Gjermani)
14.02.2025	Cúcuta (Kolumbi)
16.02.2025	Bogota (Kolumbi)
02.03.2025	do të bëhet e ditur (Nigeri)
09.03.2025	do të bëhet e ditur (Gjermani)
23.03.2025	Ushuaia (Argjentinë)
26.03.2025	Santiago de Chile (Kili)
30.03.2025	Montevideo (Uruguaj)

New Apostolic Church
International

